

SBASHK Arsimimi sot

Mars, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK me aktivitete të shumta për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe Takime solemne me koleget dhe kolegët e pensionuar



Në kuadër të aktiviteteve të shumta, një rëndësi e veçantë në SBASHK i kushtohet përgatitjes dhe mbajtjes së aktiviteteve solemne për ta shënuar ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe. Në fillimet e këtyre aktiviteteve të SBASHK-ut një delegacion i sindikatës sonë vizituan Prekazin e historisë dhe duke bërë homazhe e duke vënë lule mbi varrin e Komandantit legjendar Adem Jashari kanë përsëritur betimin në emër të gjithë anëtarësisë se do të vazhdojnë me përkushtim misionin e shenjtë për edukimin e brezave dhe do ta ruajnë në zemrat e tyre e të nxënësve kujtimin për luftën e lavdishme të ... (faqe 4)

Edhe një takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve
Në SBASHK shtohen kërkesat për të rikthyer protestat e grevat



Në takimin ... (faqe 7)

SBASHK vizitë në Qendrën Burimore "Përparimi" në Prishtinë

Përkushtim shembullor i drejtoreshës dhe i të punësuarve këtu



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ... (faqe 6)

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Aktivitete të shumta të SBASHK-ut edhe në fillimet e këtij viti



Edhe në vitin 2024 ... (faqe 3)


SBASHK në takimet me Avokatin e popullit

U prezantuan kërkesat dhe shqetësimet e anëtarësisë



Institucioni i Avoktit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudmanana Republika Kosovo
Ombudsman Institution of Republic of Kosovo

Përfaqësuesit e SBASHK-ut ... (faqe 5)



Editorial

Marsi i ngjarjeve të mëdha të kombit tonë



Në fillimet e çdo marsi qytetarët e Kosovës dhe nga vise të tjera shqiptare shkojnë në Prekazin e historisë dhe lartësojnë kujtimin për komandantin Adem Jashari dhe heronjtë dhe dëshmorët e tjerë të kombit, që me gjakun e tyre i vunë themelet e lirisë së Kosovës.

Kështu ishte edhe në fillimet e marsit të këtij viti. Përfaqësues të SBASHK-ut në kuadër të aktiviteteve për shënimin e ditës së madhe të mësuesit e shkollës shqipe vizituan Prekazin e historisë duke përsëritur betimin se do të vazhdojnë me misionin e shenjtë për edukimin dhe arsimimin e brezave.

Në fillim të çdo marsi shqiptarët kudo janë kthejnë kujtesën për datat dhe ngjarjet e mëdha që kanë lënë gjurmë në përpjekjet e njerëzve të pendës e armës për lirinë e atdheut.

Kujtojmë me krenari pishtarët e parë të dijes dhe gjithë pasardhësit e tyre që nëpër kohë furtunash mbrojtën dritën kundër errësirës që mundoheshin ta sjellin e rrënjosnin mbi atdheun tonë pushtuesit. Edhe këtë vit SBASHK nëpër komuna zhvilloi aktivitete të shumta dhe në shenjë respekti për angazhimet nëpër vite e dekada ndau mirënjohje për koleget dhe kolegët e pensionuar. Kjo datë e madhe e arsimit tonë na obligon që në shenjë respekti për pishtarët e dijes të vazhdojmë me misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave. Na obligon të vazhdojmë rrugëtimin bashkë e në SBASHK sepse unik e të bashkuar shumë më lehtë do të përballemi me sfidat e kohës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Aktivitete të shumta të SBASHK-ut edhe në fillimet e këtij viti



Edhe në vitin 2024 SBASHK-u ka vazhduar me aktivitete të shumta në shërbim të anëtarësisë dhe të arsimit në përgjithësi. Në bisedë për gazetën tonë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka veçuar disa nga këto aktivitete duke shprehur respekt për angazhimin maksimal të stafit qendror, të kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe të shumë veprimtarëve sindikalë.

Ai tregon se muaji janar e gjeti SBASHK-un duke vazhduar me angazhimet e përbashkëta me Qendrën Amerikane të Solidaritetit me qëllim që premtimin që kishin dhënë më 15 dhjetor të vitit të kaluar në një tryezë tematike me përfaqësues nga institucionet, mediet, DKA-të, Universiteti, të psikologëve, infermierëve e mjekëve për organizim në nivel të lartë të një konference kombëtare për kujdesin ndaj shëndetit mendor në shkolla ta kthejnë në realitet. Kjo edhe ndodhi dhe të gjithë pjesëmarrësit, por edhe mysafirët e nderuar, drejtorja ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington, znj. Shauna Bader –Blau, drejtori i programit rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore i kësaj qendre, z. Rudy Porter dhe përfaqësuesit sindikatave të arsimit

nga Sllovenia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë përgëzuar SBASHK-un dhe Qendrën Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë për gjithë përkushtimin dhe suksesin e këtij aktiviteti.

Kryetari Jasharaj tregon edhe për angazhimet që të takime me Avokatin e popullit dhe duke dërguar letra te deputetët e Parlamentit të Kosovës të ngitet çështja dhe të ndryshojë vendimi i gabuar i Qeverisë lidhur me plotësim-ndryshimet e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, ndryshime këto të gabuara e që godasin në të drejtën e fituar të punëtorëve të arsimit, të cilëve arsyeshëm Ligji bazik ua nje vitet e 90-ta si vite kontributdhënëse.

Në vazhdim të kësaj bisede Jasharaj tregon edhe për angazhimet dhe përgatitjet e nisura me kohë lidhur me aktivitetin tradicional të SBASHK-ut për organizimin e pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve në bregdetin shqiptar duke shprehur respekt për koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, për stafin qendror dhe për kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, që bashkërisht po angazhohen me kohë që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë sikur edhe viteve të kaluara.

Kryetari Jasharaj tregoi edhe lidhur me debatin në mbledhjen me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, nga i cili debat doli përfundimi se duke u nisur nga fakti se Qeveria vazhdon me qasjen e gabuar ndaj sindikatave dhe dialogut social, të nisin përgatitjet për veprime sindikale nëse për këtë deklarohet shumica e anëtarësisë. Në fund të kësaj bisede kryetari Jasharaj e rithekson se ai bashkë me stafin qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve do të vazhdojnë me angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të anëtarësisë .

Gjatë muajit

U mbajt takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve **Debat përmbajtjesor për gjithë çështjet aktuale në arsim**



SBASHK në Sallën e takimeve në Qendrën e studentëve ka mbajtur takimin e radhës me kryetarët Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve. Në këtë takim është debatuar për çështje aktuale në arsim dhe janë caktuar detyra konkrete për angazhimet e radhës. Në fillim të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala e koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë kujtuar për aktivitetet e zhvilluara në kohën nga takimi i kaluar e deri me tani e duke u ndalur veçmas te Konferenca e organizuar bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë, aktivitet ky i vlerësuar lart nga drejtorja ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington, znj.Shauna Bader-Blau, por edhe nga gjithë pjesëmarrësit tjerë.

Pas kësaj u fol edhe për angazhimet e SBASHK-ut lidhur me kundërshtimet ndaj ndryshim propozimeve të bëra në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, të cilat prekin në të drejtat e fituara e të punësuarve në sistemin arsimor. U theksua se shqetësimet SBASHK-u

i ka prezantuar në takimet me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe në takim me avokatin e popullit, nga i cili është kërkuar që çështjet t'i adresojë në Gjykatën Kushtetuese.

Në vazhdim të takimit është bashkëbiseduar edhe për iniciativën e ardhur nga disa DKA për ndërhyrje në Kontratat individuale të punës, ndërhyrje këto që do të preknin në normat e punës së një pjese të punëtorëve të arsimit.



SBASHK kundërshton iniciativat e tilla duke theksuar se kjo është çështje që ka gjetur me kohë zgjidhje të duhur dhe si të tilla edhe duhet të mbesin.

Në këtë takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve është biseduar edhe për aktivitetet solemne që do të zhvillohen për nder të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe.

U vendos që aktivitete solemne të zhvillohen nëpër gjithë komunat dhe në universitete, për të shprehur respekt meritore për koleget dhe kolegët që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij vit.

SBASHK me aktivitete të shumta për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe **Takime solemne me koleget dhe kolegët e pensionuar**



Në kuadër të aktiviteteve të shumta, një rëndësi e veçantë në SBASHK i kushtohet përgatitjes dhe mbajtjes së aktiviteteve solemne për ta shënuar ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe.

Në fillimet e këtyre aktiviteteve të SBASHK-ut një delegacion i sindikatës sonë vizituan Prekazin e historisë dhe duke bërë homazhe e duke vënë lule mbi varrin e Komandantit legjendar Adem Jashari kanë përsëritur betimin në emër të gjithë anëtarësisë se do të vazhdojnë

me përkushtim misionin e shenjtë për edukimin e brezave dhe do ta ruajnë në zemrat e tyre e të nxënësve kujtimin për luftën e lavdishme të UÇK-së për lirinë e atdheut. Po më 6 mars në disa komuna filluan aktivitetet solemne të organizuara nga SBASHK për të shprehur respektin meritor për pishtarët e dijes që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti dhe për gjithë pishtarët e dijes që u angazhuan në misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave nëpër vite e dekada.



Në këto ceremoni festive, që vazhduan edhe më 7 mars,

kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve shprehen respekt për koleget e kolegët e pensionuar duke vlerësuar lart kontributin e tyre me vite e dekada në sistemin arsimor të Kosovës. Ata ndanë në emër të SBASHK-ut edhe mirënjohje, që shprehin këtë respekt të lartë për pishtarët e dijes. Ndjejmë obligim të përmendim se në mëngjesin e 7 marsit kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj ka telefonuar kryetarin e SBASHK-ut duke ia uruar atij dhe gjithë punëtorëve të arsimit 7 Marsin e duke shprehur respekt të lartë për pishtarët e dijes që kanë kryer me përkushtim misionin e tyre të shenjtë në edukimin dhe arsimin e brezave nëpër vite e dekada.




SBASHK në takimet me Avokatin e popullit U prezantuan kërkesat dhe shqetësimet e anëtarësisë



Institucioni i Avokatisë së Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin zhvilluar një takim përmbajtësor me Avokatin e popullit, z. Naim Qelaj duke ia prezantuar gjithë kërkesat e shqetësimet e anëtarësisë. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e zyrtari ligjor Blendor Shatri ishin ndalur edhe të ndryshim-plotësimet shumë të dëmshme që sjell Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe kanë kërkuar që Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese.

Avokati i popullit në këtë takim ishte shprehur se do të organizojë një takim me përfaqësues të shumë prej Federatave sindikale për të bashkëbiseduar për gjithë shqetësimet dhe për situatën aktuale në tërë sektorin publik dhe atë privat në Kosovë. Ky takim edhe ndodhi dhe pas fjalës hyrëse të Avokatisë së Popullit, përfaqësuesit sindikal nisen me prezantimin e halleve e shqetësimeve të shumta të anëtarësisë që përfaqësojnë. Kryetari Jasharaj është shprehur në këtë takim se ky është një institucion shumë të respektuar e që gëzon besimin e qytetarëve dhe prandaj kërkohet angazhimi i vazhdueshëm i Avokatisë të



popullit dhe stafit të tij aq më shumë kur Kurti dhe qeveria e tij i kanë mbyllur dyert ka kohë dhe i ikin takimeve me sindikatat, të cilat edhe u munduan t'i shuajnë, por nuk ia dolën.

“I nderuar Avokat i popullit gjithë ankesat dhe shqetësimet që i thamë janë të anëtarësisë dhe ato janë shumë dhe sa vijnë e shtohen duke mos pasur zgjidhje të duhura për to nga ana e Qeverisë. Edhe më keq se kjo duke vazhduar luftën kundër sindikatave e duke bllokuar dialogun dhe punën edhe të Këshillit Ekonomik Social Qeveria po vendos kokë me vete duke punuar Ligje të gabuara e duke bërë ndryshime e plotësime të ligjeve në dëm të punëtorëve në të gjitha sektorët dhe ndaj të pensionuarve. Me këto veprime Qeveria po vazhdon ta lëndojë demokracinë. Avokat i nderuar të përgëzoj për iniciativën shumë të qëlluar që na e bërë publike dje se do të bësh të pamundurën që të organizosh një takim me përfaqësues të sindikatave dhe të Qeverisë.”, është shprehur Jasharaj në prezantimin e tij duke u ndalur në gjithë shqetësimet dhe kërkesat legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut e duke kërkuar mbështetjen e këtij institucioni të respektuar.

Letër deputeteve dhe deputetëve të Parlamentit të Kosovës

Kërkesë që të zgjedhurit e popullit të mbrojnë të drejtat e fituara të punëtorëve

Pas takimeve me Avokatin e popullit dhe konfirmimit nga ai se ka adresuar në Kushtetuese disa nga çështjet e ngritura lidhur me plotësim-ndryshimet e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, SBASHK ka vazhduar me angazhimet lidhur me këtë dhe çështje të tjera duke u dërguar letra shefave të Grupeve parlamentare e përmes tyre edhe deputeteve e deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Në këtë letër SBASHK ka shkruar se nuk mund të besojmë se cila do deputete, apo cili do deputet shqiptar do të votonte këto ndryshime sikur t'i lexonte me vëmendje e të mos ishte i magjepsur nga bindja se po përmirësohej një padrejtësi që u ishte bërë të dëbuarve dhunshëm nga puna. "Nuk besojmë se në Parlament të Kosovës do të kalonte ndryshimi që sjell Neni 3, i cili thotë se: " fshihet paragrafi 6 i nenit 8 të Ligjit bazik". Paragrafi 6 në Ligjin bazik, nr.04/L-131, e ka pranuar një të drejtë legjitime të punëtorëve të arsimit të viteve të 90-ta dhe thotë: "Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës". Thuhet në këtë letër.

Duke dhënë argumente lidhur me këtë çështje SBASHK ka kujtuar se kjo e drejtë iu pranua punëtorëve të arsimit shqip për ato vite nga Deputetët sepse ata e dinin, dhe shumë nga

ata e kanë përjetuar atë kohë, që punëtorët e arsimit shqip gjatë gjithë viteve të 90-ta kishin punuar të përballur me dhunën, përndjekjet, burgosjet e me vrasjet nga pushtuesi serb. Punëtorët e arsimit të atyre viteve e mbajtën gjallë arsimin shqip dhe procesi mësimor nuk u ndal as edhe për një moment sepse aty nuk lejonte pushtuesi të mbahej mësimi në shkolla, u punua në shtëpitë shkolla. "Pra, këto vite u pranuan si kontribut dhënës, jo si sadaka a peshqesh nga shteti, po sepse punëtorët e arsimit punuan në atë kohë dhe ata nuk ia kishin ngenë të mendonin për kontribute pensionale, po angazhoheshin në kuadër të Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptar "Naim Frashëri", në kuadër të SBASHK-ut dhe bashkë me Aktivin e Drejtorëve për të mos u ndalë as edhe për një ditë mësimi në ato kushte të tmerrshme e për ballë dhunës së paparë të pushuesit e me shpresën se kur të agojë liria shteti ynë do ua pranojë ato vite si kontributdhënës dhe kjo edhe ndodhi deri në momentin Ligjit Bazik", kujton deputetët SBASHK-u përmes kësaj letre.

Në fund të kësaj letre SBASHK u drejtohet me lutje deputetëve të pozitës dhe opozitës që të angazhohen dhe këto ndryshime të gabuara të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti t'i kthejnë për debat në parlament dhe të merren vendime të duhura për vitet e 90-ta.

SBASHK vizitë në Qendrën Burimore "Përparimi" në Prishtinë Përkushtim shembullor i drejtoreshës dhe i të punësuarve këtu



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën, Ahmet Pllana kanë vizituar Qendrën Burimore "Përparimi" në Prishtinë për të bashkëbiseduar për çështje arsimore dhe për angazhimet dhe aktivitetet sindikale. Rregull, pastërtia, ambientet e përgatitura për aktivitete mësimore jepnin pamje të një institucioni, në të cilin ka përkushtim shembullor të drejtoreshës dhe gjithë të punësuarve këtu.

Duke ju dëshiruar mirëseardhje mysafirëve drejtoresha Igballe Asllani- Potera, ka shpjeguar për angazhimet

që bëhen në këtë institucion të veçantë arsimor duke u shprehur krenare për gjithë të punuarit këtu që bëjnë edhe të pamundurën që procesi mësimor të ketë rrjedhë të mbarë. Pas kësaj mysafirët bashkë me drejtoreshën kanë vizituar edhe ambientet e këtij institucioni arsimor, që dëshmonin për punën, kujdesin dhe përkushtimin e të punësuarve këtu. Pas kësaj përfaqësuesit e SBASHK-ut bashkë me kryetaren



e shoqatës sindikale Drita Dushi-Parduzi të këtij institucioni arsimor kanë mbajtur një takim me të punësuarit në këtë Qendër burimore dhe kanë bashkëbiseduar për aktualitetin në arsim, për sfidat me të cilat përballeshin mësimdhënëset

dhe të punësuarit tjerë në këtë institucion arsimor. Kryetari Jasharaj ka përgëzuar drejtoreshën dhe gjithë të punësuarit për angazhimet dhe përkushtimin në misionin e shenjtë që kanë, kurse nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, u

janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrëseve në këtë takim duke marrë edhe ide e kërkesa konkrete që kanë të bëjnë me të drejtat e punës dhe lidhur me çështje që ndërlidhen me natyrën e punës arsimore e edukative në këtë institucion të veçantë arsimor.

U mbajt Kuvendi i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Ferizaj **Bashkëbisedë përmbajtjesore me kryetarët e shoqatave sindikale**



Në sallën e takimeve të Asamblesë komunale në Ferizaj është mbajtur Kuvendi i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Në hapje të këtij takimi kryetari i këtij Kuvendi Fejzullah Vranovci ka përshëndetur të pranishmit dhe në emër të tyre ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetaren e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë në kuadër të SBASHK-ut, Hanife Salihu. Kryetari Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar anëtarët e këtij kuvendi, veprimtarët sindikalë dhe gjithë anëtarësinë në Ferizaj për angazhimet dhe unitetin e përkushtimin e treguar në realizimin e detyrave konkrete sindikale dhe në forcimin e vazhdueshëm të unitetit dhe zërit sindikal.

Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Ferizaj, Fejzullah Vranovci pastaj



ka bërë një përshkrim të angazhimeve në nivel të komunës duke shprehur respekt meritore për angazhimet e vazhdueshme të stafit qendror të SBASHK-ut në realizim të kërkesave të anëtarësisë nga kjo komunë duke veçuar edhe trajnimet e organizuara në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë dhe aktivitetet e shumta sindikale.

Pas kësaj takimi është zhvilluar përmes një bashkëbisede me pjesëmarrësit të cilët kanë treguar për situatën aktuale në institucionet e tyre arsimore dhe kanë drejtuar edhe pyetje konkrete në të cilat janë përgjigjur nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Kryetari Fejzullahu, anëtarët e kryesisë dhe gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi kanë shprehur respekt për angazhimet e stafit qendror të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë duke u shprehur se do të vazhdojnë me angazhimet për realizimin e detyrave konkrete në shërbim të anëtarësisë .

Edhe një takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve **Në SBASHK shtohen kërkesat për të rikthyer protestat e grevat**



Në takimin e rregullt me kryetarët e nivelit komunal dhe të universiteteve që ka organizuar SBASHK

janë zhvilluar bashkëbiseda për situatën aktuale në arsim dhe janë hedhur vërejtje e kritika të shumta në adresë të Qeverisë Kurti për mungesë të dialogut, për qasjen e gabueshme ndaj sindikatave dhe kërkesave të anëtarësisë dhe për tendencën e ministrit Murati që të mohojë me ndryshime të ligjeve aktuale të drejtat e fituara të punëtorëve të arsimit.

Në këtë takim është kritikuar edhe ngritja ironike e koeficientit të pagës nga 105 në 110 euro duke e cilësuar si nënçmuese ngritjen prej vetëm 28 euro të pagave në sistemin arsimor parauniversitar. Përfaqësuesit e të punësuarve në tërë sistemin arsimor, që nga çerdhet e deri në universitete kanë paraqitur gjithë shqetësimet dhe kërkesat e anëtarësisë para kryetarit të SBASHK-ut

Rrahman Jasharaj dhe stafit qendor dhe pas diskutimeve të shumta të gjithë kanë ardhur në përfundim se duke parë qëndrimin negativ të Qeverisë Kurti ndaj sindikatave dhe zërit të anëtarësisë dhe duke parë se Ministri Murati vazhdon angazhimet kundër dialogut sindikal duke bllokuar punën e Këshillit Ekonomik Sindikal,

Duke parë se po vazhdon bllokimi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke parë se ministrja Nagavci vazhdon me inatet dhe nuk përfaqëson kërkesat e punëtorëve të arsimit dhe mundohet ta mohojë edhe Kontratën Kolektive për Arsimin e Kosovës, pjesëmarrësit në këtë takim kanë nxjerr si përfundim se duhet vazhduar me bashkëbisedat me anëtarësinë dhe duhet rikthyer veprimet sindikale duke filluar me një protestë me gjithë udhëheqësit sindikal të shkollave, çerdheve dhe universiteteve e institucioneve të kulturës e nëse Qeveria Kurti vazhdon me qasjen e njëjtë

injoruese atëherë të vazhdohet me veprime sindikale duke paralajmëruar se do të përsëritet viti 2022 me një grevë të përgjithshme më 1 shtator, e cila do të vazhdojë deri në plotësimin e plotë të kërkesave të anëtarësisë.

SBASHK me këtë alarm publik iu drejtohet edhe medieve, shoqërisë civile, deputeteve e deputetëve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës që ta ngritin zërin dhe të kërkojnë nga Qeveria që të ndryshojë qasjen ndaj dialogut dhe të realizojë kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut dhe sindikatave tjera sepse në të kundërtën do të kthehet ajo që ndodhi në vitin 2022 kur tërë sistemi arsimor ishte në veprime sindikale e pastaj edhe në grevë të përgjithshme, e cila fatkeqësisht zgjati më shumë se një muaj. Nëse Qeveria vazhdon kështu, atëherë protestat e grevat do të rikthehen dhe fajtorët janë Kryeministri Kurti, Ministri Murati e Ministrja Nagavci dhe jo vetëm.

SBASHK në akademinë perkujtuese në Mitrovicë

U perkujtuan figurat e ndritura të kombit Latif Berisha e Agim Hajrizi



Në Qendrën kulturore “Kadri Kadriu” në Mitrovicën veriore është mbajtur aktivitet perkujtues për të lartësuar kujtimin për figurat e ndritura të kombit tonë Latif Berisha dhe Agim Hajrizi, në këtë akademi perkujtimi kanë marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me kryetarin e Odës së Hotelerisë e Turizmit prof. dr.Hysen Sogojeva.

Në fillimet e këtij aktiviteti perkujtues përfaqësuesit e PEN Qendrës Milazim Krasniqi e Salë Bashota kanë

shpalosur kujtime për veprën letrare e angazhimin atdhetar të Latif Berishës dhe për angazhimet sindikale e atdhetare të Agim Hajrizit.

Për angazhimin në shërbim të kombit e atdheut të këtyre dy figurave të ndritura kanë folur edhe kryetari i BSPK-së Atdhe Hykollli dhe veprimtari sindikal Abit Rrustemi. Familjarët Berisha dhe Hajrizi kanë shprehur respekt për përfaqësuesit e SBASHK-ut duke i falënderuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet perkujtues.

